Kronikë

Atentati me 3 të vdekur e 1 të plagosur në Shkodër, dyshohet për 4 autorë, 2 prej tyre qitës! Burimet: Dyshohet për vrasës me pagesë nga Mali i Zi! Safet Bajri: S'kam lidhje

*Rreth **20 persona janë marrë në pyetje për atentatin** me 3 të vrarë dhe 1 të plagosur në Shkodër. Mes tyre edhe Safet Bajri, i cili ka mohuar të ketë lidhje me ekzekutimin e Hamza Licit dhe Arlind Bushatit. Katër dyshohet të kenë qenë autorët, dy qitës dhe shoferi, si edhe një person që i ndihmoi të largohen pas djegies së makinës.*
Bajri: Isha në banesë me familjen

■ VIDEO/ Momenti kur Bushati u kërcënua me armë 2 javë më parë

■ VIDEO/ Makina e djegur e autorëve, brenda 2 kallashë

■ VIDEO/ Atentati në Shkodër, grupi hetimor kthehet në skenën e krimit, vendngjarja ende e rrethuar me shirit

■ Atentati në Shkodër, policia dyshime se autorët janë vrasës me pagesë nga Mali i Zi! Numri i shasisë së mjetit i dëmtuar nga zjarri

■ Humbi jetën pasi u qëllua me plumb në kokë, si denoncoi Arlind Bushati dy javë me parë se u kërcënua me armë

■ Atentat në Shkodër me 3 të vrarë e 1 të plagosur! Vritet vëllai i Ibrahim Licit dhe djali i Xhemal Bushatit! Vdes qytetarja e pafajshme, rëndë bashkëshorti i saj

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Ergys Kavaja

Sokol Dema

31 Tetor, 08:52 | Përditesimi i fundit: 31 Tetor, 11:09

Share

SHKODËR- Katër autorë dyshohet të kenë marrë pjesë **në ekzekutimin e Hamza Licit dhe Arlind Bushatit** pasditen e 30 tetorit 2024 në Dobraç të Shkodrës. Burime për Report Tv e Shqiptarja.com bëjnë me dije se ka dyshime se autorët janë vrasës me pagesë nga Mali i Zi.

Burime bëjnë me dije se në makinën 'Range Rover' të autorëve ishin dy qitës të cilët kanë qëlluar me breshëri kallashi ndaj mjetit të Licit dhe Hamzait. Ndërkohë, një person i tretë ka qenë duke drejtuar mjetin, ndërsa burimet thonë se është i përshirë edhe një tjetër autor që i ka ndihmuar qitësit të largohen pasi dogjën makinën.

Rreth 20 persona janë shoqëruar në Policinë e Shkodrës, mes tyre edhe Safet Bajri. Ky i fundit ka qëndruar rreth 2 orë në polici dhe mësohet se ka mohuar të ketë lidhje me atentatin. Burimet thonë se Bajri ka deklaruar se gjatë kohës kur ka ndodhur atentati ka qenë në shtëpi me familjen. Sipas tij, shtëpia është e monitoruar me kamera, që provon se ka qenë në banesë në momentin kur ka ndodhur atentati.

[Sh].com

LEXO EDHE:
Të pafajshmit viktima të krimit! Nga banakierja e Don Boskos te kamarieri i Memaliajt dhe kalimtarja në Shkodër! Atentatet kriminale që tronditën vendin

Viktimë e atentatit mbeti Hamza Lici, vëllai i vogël i të fortit të Shkodrës Ibrahim Lici dhe Flutura Basha, një qytetare e pafajshme që po udhëtonte me bashkëshortin e saj me motor në momentin kur ndodhi atentati. Disa orë më vonë humbi jetën në spital dhe **Arlind Bushati**. Djali Xhemal Bushatit, ish-kandidati i PD për kryebashkiak të qytetit të Shkodrës, që po udhëtonte me Hamza Licin në makinën Benz C- Class me targa kroate. Ndërsa në spital në gjëndje të rëndë është **Bashkim Basha**, bashkëshorti i Fatbadhës.

Masakra e së mërkurës në Shkodër riktheu frikën e dhunës së bandave dhe la pas një viktimë të pafajshme. Çifti Basha që udhëtonte me motoçikletë u përplas nga makina e për pasojë ndërroi jetë 56-vjeçarja Flutura Basha, ndërsa bashkëshorti i saj, 67-vjeçari Bashkim Basha po lufton për jetën në spital.

Atentatorët kanë qëlluar me breshëri automatiku dhe në vendngjarje janë gjetur me dhjetëra gëzhoja, siç shihet në pamjet e Report tv. Pak orë më vonë, Policia gjeti në zonën e Grudës së Re një automjet Land Rover model tip, u shkrumbuar. Në brendësi u gjetën dy automatikë që dyshohet se janë përdorur në ngjarje.

Viktimat e atentatit në Shkodër 30 tetor 2024
Të vrarë Hamza Lici - Vëllai i Ibrahim Licit - 23 vjeç Flutura Basha - qytetare, po levizte me motor me burrin - 66 vjeçe Arlind Bushati - Djali i Xhemal Bushatit - 32 vjeç - Vdiq pas disa orësh në spital
I plagosur rëndë Bashkim Basha - bashkëshorti i Fluturës - 67 vjeç

1 / 11



Hamza Lici dhe Arlind Bushati

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 11:02

Atentati në Shkodër, policia dyshime se autorët janë vrasës me pagesë nga Mali i Zi! Numri i shasisë së mjetit i dëmtuar nga zjarri

Grupi hetimor i Policisë së Shkodrës dhe Policisë Kriminale ka dyshime se autorët janë vrasës me pagesë nga Mali i Zi, në moshë të re. Makina e viktimave rezulton të ketë hyrë në vendin tonë po ashtu nga Mali i Zi në ditët e fundit dhe ka bërë lëvizje në afërsi të zonës së Dobraçit disa herë.

Sipas gazetarit të Report Tv, Sokol Dema, hetuesit kanë sekuestruar më shumë se 35 gëzhoja në vendngjarje. Makina e djegur e autorëve, deri tani nuk ka prodhuar asnjë të dhënë për grupin hetimor, pasi numri i shasisë është dëmtuar nga zjarri, megjithatë është dërguar për ekspertim me shpresën se mund të zbulohet.

Të djegura plotësisht janë edhe targat. Hetuesit janë përqendruar te kamerat e sigurisë, por po haset vështirësi pasi në zonë ose nuk ka kamera, ose edhe ata që janë nuk kanë server për ruajtje pamjesh. Disa prej tyre janë të koduara dhe janë marrë për t'u ekspertuar në laborator.

S.B/Shqiptarja.com

Share

Ora 10:30

Atentati me 3 viktima në Shkodër, ministri i Brendshëm: Shumë shpejtë do kemi rezultate konkrete! Po punohet për arrestimin e autorëve

Ministri i Brendshëm, Ervin Hoxha ka reaguar pas masakrës me 3 viktima që ndodhi një ditë më parë në Shkodër, (30 tetor) ku humbën jetën 23-vjeçari Hamza Lici, 32-vjeçari Arlind Bushati dhe një grua, e cila udhëtonte me motor me bashkëshortin e saj, pasi u përplas nga makina e Hamza Licit dhe Arlind Bushatit.

Teksa u pyet nga gazetarët në ambientet e jashtme të Kuvendit, ai u shpreh se të gjitha forcat e policisë së shtetit kanë shkuar në Shkodër për të bërë të mundur arrestimin e autorëve.

Ai deklaroi se shumë shpejt do të ketë rezultate konkrete në lidhje me ngjarjen.

> *"Dje të gjitha forcat e Policisë së Shtetit kanë shkuar në Shkodër për të bërë të mundur arrestimin e autorëve. Ata janë atje për të bërë detyrën e tyre. Shumë shpejt do të kemi një rezultat konkret në lidhje me ngjarjen që ka ndodhur dje", tha ministri.*

S.B/Shqiptarja.com

Share

Ora 09:51

VIDEO/ Atentati në Shkodër, grupi hetimor kthehet në skenën e krimit, vendngjarja ende e rrethuar me shirit

Report Tv sjell pamjet nga vendi ku ndodhi atentati një ditë më parë në Dobraç të Shkodrës. Siç shihet edhe në pamje, vendi ku ka ndodhur krimi është ende i rrethuar me shitit pasi grupi hetimor u kthye sot në vendin e ngjarjes sërish.

Tre persona mbetën të vrarë nga atentati në zonën e Dobraçit, Hamza Lici, vëllai i Ibrahim Licit, si edhe Arlind Bushati dhe një kalimtar.

SI.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 09:08

Atentati me 3 viktima në Shkodër, zbardhet dëshmia e Safet Bajrit: Nuk kam lidhje, isha në shtëpi me familjen

Rreth 20 persona janë shoqëruar pas atentatit me 3 viktima dhe 1 të plagosur në Shkodër, të cilët pasi kanë dhënë deklarime janë liruar.

Mes të shoqëruarve ishte edhe Safet Bajri. Gazetari i Report Tv, Sokol Dema ka siguruar dëshminë e tij para uniformave blu.

Safet Bajri është mbajtur vetëm 2 orë në Policinë e Shkodrës. Në deklarime ka thënë se ka qenë në shtëpi me familjarët e vetë dhe nuk ka asnjë lidhje me atentatin. Sipas tij është i monitoruar në kamera gjithandej në shtëpi, të cilat provojnë se gjatë kohës së vrasjes ka qenë në shtëpi.

SI.E./Shqiptarja.com

Share

SI.E./S.B/Shqiptarja.com

TAG: Shkoder | Hamza Lici | atentat hamza licit | arlind bushati

Komento

Komente

Bim: 31/10/2024 09:46

Shpresojm qe shqiptaret te kuptojn qe skafandra vehet ne koke per te shpetuar jeten. Ndoshta kan marre edhe ndonje plumb por ka mundsi qe s'kan marre asnje dhe me nje skafander kishin shpetuar jeten

Përgjigju

Shkodra: 31/10/2024 09:26

O safet po mir mor burr e zem se shkove der te ibrahimi, po si do ja besh me sokolin, lulin, blertin, media etj. Ti ke gjith shkodren kunder mo ta marrsha. 1 her po dole neper shkoder e ke pre bileten

Përgjigju

miri: 31/10/2024 10:15

po keta jane te gjitje nga 50-60 vjec o bur ne kohe te vet po por do gjynje ajo pune edhe safeti po shko 40 mos them ka shku

Rusi: 31/10/2024 10:02

Shko mor q.. motren . Ska pm qe ju afrohet bajreve . Bajret kan ba vrasjet ma te forta ne shkoder . Lict vec ferracakt e shkret e nej burr 70 vjec tu shit peshk

Shkodrani vjeter: 31/10/2024 09:26

Ka shpetu manifatura e atelia nga arlindi , dit nat grumbullote tan horat e kriminelet e shkodres te rrugica shpis tij. Dote me u ba i fort mezor , me tan ato pasunina qe ka vec qerana merr ne muj 15 milion lek . Po malli , kumara e moren ne qaf

Përgjigju

Ndoca: 31/10/2024 09:18

Skutari djep kultunet mor ta marrsha.

Përgjigju

Luli: 31/10/2024 08:58

Thojn Njai stan njat bulmet ka pas

Përgjigju

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Mendoni se lufta ndaj nëndeklarimit të pagave do rrisë ndjeshëm pensionet?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

VIDEO/ U vra në atentatin në Shkodër, pamjet kur Arlind Bushati u kërcënua pak ditë më parë! Persona me motor dhe të maskuar i drejtojnë armën teksa ishte i ulur në lokal

31 Tetor, 09:23

Atentati në Shkodër me 2 të vrarë u plagos rëndë dhe djali ish kandidatit të tij! Reagon Basha: Këmbanë alarmi! Bardhi: Policia mbron krimin

30 Tetor, 19:27

Atentati që tronditi Shkodrën/ Poli Hoxha: Mund të jetë bërë nga vrasës me pagesë! Të gjithë i dinë konfliktet atje por askush nuk ndërhyn

30 Tetor, 17:37

SKEDA/ Kush është Ibrahim Lici, një nga 'të fortët' e Shkodrës! Konfliktet me Bajrat dhe Bilalët dhe saga me 11 të vrarë

30 Tetor, 16:49



Atentati në Shkodër, i plagosur rëndë djali i ish-kandidatit të PD për bashkinë! Pak ditë më parë denoncoi se u kërcënua me armë nga 2 persona në Pedonale

30 Tetor, 16:44

Atentat në Shkodër me 3 të vrarë e 1 të plagosur! Vritet vëllai i Ibrahim Licit dhe djali i Xhemal Bushatit! Vdes qytetarja e pafajshme, rëndë bashkëshorti i saj! Gjendet 'Range Rover' i djegur me dy automatikë

Ergys Kavaja

Sokol Dema

30 Tetor, 15:51

Shkodër/ Digjen 2 makina! Ishin në përdorim nga agjenti i krimeve! Hijet që fshihen pas (EMRI)

30 Tetor, 11:18

Shkodër/ U përplas nga një mjet, humb jetën 62-vjeçari! Digjen 2 makina

30 Tetor, 08:22



'Klasikja' Tirana - Vllaznia luhet në Lushnje, Thomas Brdaric: Është çmenduri, fusha jo e mirë

29 Tetor, 12:15

Zbardhet plagosja në Koplik! Arrestohet autori që qëlloi në këmbë 32 vjeçarin (EMRI)

27 Tetor, 11:43



I riu përplas për vdekje 70-vjeçarin në Shkodër, shoqërohet në polici (EMRAT)

26 Tetor, 20:02

Një tjetër turist zhduket në Alpet shqiptare, australiani do shkonte nga Valbona në Theth! Për herë të fundit u pa para 13 ditësh

26 Tetor, 17:49

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje